

TIRANË / SHQIPËRI

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË

PROINFINIT AUDIT TAX & CONSULTING SH.P.K.

Tiranë, më 26 qershor 2023

KAPITULLI
EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA, KOHËZGJATIA

Sot, më 26/06/ 2023 në Tiranë, **Znj. Desara Liko** dhe **Z. Glen Papadhima** si më poshtë **“Ortakët”** përpilojnë këtë Akt Themelimi dhe Statut të Shoqërisë PROINFINIT AUDIT TAX & CONSULTING Sh.p.k. si më poshtë vijon:

Neni 1.
Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1. Emërtimi i Shoqërisë është **PROINFINIT AUDIT TAX & CONSULTING** (“Shoqëria”). Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e nxjerra nga Shoqëria, emri i saj do të shoqërohet nga:
 - a. Fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “Sh.p.k.”;
 - b. Selia.

Neni 2.
Forma Ligjore e Shoqërisë

- 2.1. Shoqëria tregtare **PROINFINIT AUDIT TAX & CONSULTING** është person juridik shqiptar, i organizuar ligjërisht si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (**“Ligji për Shoqëritë Tregtare”**) dhe dispozitat e këtij Akti Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë.
- 2.2. Aktiviteti i Shoqërisë rregullohet nëpërmjet këtij statuti (“Statuti”).

Neni 3.
Selia e Shoqërisë

- 3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: **“Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. Tish Daija, Zona Kadastrale 8260 Nr. Pasurie 6/759+3-14, Kompleksi Kika 2, Objekti 7, Shkalla 7, Kati 5, Tiranë, Shqipëri”**. Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe/ apo në një qytet tjetër të Shqipërisë.
- 3.2. Shoqëria rezervon të drejtën të hapë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 4.
Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të papërcaktuar.

KAPITULLI II
OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 5.
Objekti i Shoqërisë

- 5.1. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e menaxhimit të biznesit, shërbime të auditimit, auditimit ligjor, konsulencës financiare, taksave, shit-blerjen ose bashkimin e kompanive, plane fizibiliteti, plane biznesi, studime dhe analiza si dhe të gjitha shërbimet në fushën e konsulencës në të gjithë sektorët dhe industrinë për individë dhe subjekte. Shërbime outsourcing brenda dhe jashtë vendit. Konsulencë bizneseve mbi inpaktin dhe përdorimin efikas të burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe optimizimit të kostove. Vlerësimin e pronave dhe pasurive të paluajtshme. Ngritje të kapaciteteve dhe konsulencë në drejtimin menaxherial dhe operativ. Mbajtje të kontabilitetit, evidencave financiare ose operacionale, kryerje të proceseve të biznesit, shërbime të perkthimit, redaktimit dhe prezantimit të punimeve, materialeve, raporteve dhe studimeve të ndryshme. Hartim të manualeve, procedurave, udhëzimeve. Shërbime të traninimit dhe zhvillimit, kurse të formimit profesional. Ndërmjetesim për tregun e punës, rekrutime, trainime dhe programe kualifikimi të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie/marrje me qera, të vendose pengje dhe barrë hipotekore, aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër, të blejë në mënyre direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit, të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.

Neni 6.
Ndryshimet

- 6.1. Shoqëria rezervon të drejtën për të ndryshuar objektin në çdo kohë, ashtu siç përcaktohet në statut.

KAPITULLI III
ORTAKËT THEMELUES DHE KAPITALI THEMELTAR

Neni 7.

Ortakët Themelues dhe Kapitali Themeltar

- 7.1. Ortakët themelues të Shoqërisë janë **Znj. Desara Liko**, e datëlindjes 12.08.1982, lindur në Tiranë, Shqipëri, banuese në Tiranë, me numër personal identifikimi I25812051J dhe **Z. Glen Papadhima**, i datëlindjes 16.06.1997, lindur në Bari, Itali, me numër personal identifikimi J70616065M.
- 7.2. Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **1,000,000 (një milion) Lek** dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota të zakonshme si më poshtë:
- (i) **Znj. Desara Liko**, zotëruese e 1 (një) kuote që përfaqëson **51%** të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 510,000 LEK.
- (ii) **Z. Glen Papadhima**, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson **49%** të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 490,000 LEK.

Neni 8.

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 8.1. Zmadhimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë ("**Asambleja e Përgjithshme**"), në çdo kohë dhe më shumë së një herë, përmes kontributeve në para apo në natyre, në zbatim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe parashikimeve të këtij Statuti.
- 8.2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 8.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në zbatim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe parashikimeve të këtij Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet përtej minimumit të parashikuar me ligj.
- 8.4. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë përballohet nga secili prej ortakëve në përpjestim me vlerën nominale të kuotës që ka në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9.

Të Drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve

- 9.1. Ortakët janë vetëm ata të cilët zotërojnë Kuota të Shoqërisë.
- 9.2. Kuotat japin të drejtën e një vote në Asamblesë e Përgjithshme, të drejtën për të zgjedhur apo për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marre pjese në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë (sipas këtij Statuti dhe dispozitave të tjera ligjore), apo të drejtave të tjera përcaktuese në këtë Statut.

- 9.3. Çdo ortak ka të drejta vote në Asamblenë e Përgjithshme në përpjestim me vlerën nominale të kuoteë ëë tij si edhe i jep të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, në përpjestim me vlerën nominale të kuotës.
- 9.4. Ortakëve, do t'u jepen në çdo kohë, të gjitha informacionet dhe të dhënat, pa patur nevojë për kërkesë me shkrim, në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohe, duke përfshirë edhe të drejtën për të konsultuar librat dhe dokumentat e Shoqërisë.
- 9.5. Te drejtat dhe detyrimet të cilat burojnë nga zoterimi i kuotave i transferohen çdo ortaku të ri të kuotës.
- 9.6. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nëpërmjet kapitalit themeltar, dhe ortakët mbajnë përgjegjësi vetëm për vlerën e kuotave që ata zotërojnë; ortakët nuk kanë përgjegjësi tjetër përveç kuotave të tyre në kapitalin themeltar të Shoqërisë (me përjashtim të garancive personale të dhena për huatë e Shoqërisë ose për detyrime të tjera).
- 9.7. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhet apo detyrimet personale të ortakëve të saj.

Neni 10. Transferimi i Kuotave

- 10.1. Kuotat mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve;
- 10.2. Pjesët e kapitalit themeltar (kuotat) mund t'u transferohen personave të tretë, të vihen peng, barrë apo çdo mjet tjetër sigurimi mbi kuotat, vetëm me miratimin e të tre ortakëve konform Marreveshjes së Ortakëve dhe dispozitave të këtij Statuti.
- 10.3. E drejta e parablerjes mes ortakëve rregullohet me marreveshje të veçante mes ortakëve / Marreveshja e Ortakëve.
- 10.4. Në rastin kur një Ortak ka për qëllim të transferojë të gjithë apo një pjesë të kuotave të tij në persona të tretë të ndryshëm nga Ortaket, ai, para se të nënshkruajë marreveshje me persona të tretë, ka detyrimin të njoftojë me shkrim Administratorin për transferimin e planifikuar, duke përcaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at të cilëve planifikon t'u transferojë kuotat dhe kushtet e transferimit.
- 10.5. Administratori, brenda 7 ditëve zyrtare pune duke filluar nga dita që ka marrë dijeni për njoftimin për transferimin e planifikuar të kuotave do të informojë me shkrim Ortakët e tjerë.
- 10.6. Secili nga Ortaket, brenda 7 ditëve zyrtare pune nga data e marrjes së njoftimit nga Administratori për shitjen apo transferimin e planifikuar, detyrohet të njoftojë me shkrim Administratorin nëse ka qëllim të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.
- 10.7. Administratori, brenda 7 ditëve zyrtare pune nga data e marrjes së njoftimit nga Ortaku për të drejtën e tij të parablerjes, do të njoftojë me shkrim Ortakun që dëshiron të transferojë kuotat e tij.
- 10.8. Nëse me shume se një Ortak ushtron të drejtat e parablerjes, ata do të fitojnë këto kuota në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kohën e transferimit në kapitalin themeltar.

- 10.9. Nëse një Ortak ka dhene njoftim për qëllimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ky Ortak do të ketë të drejtë të bleje kuotat objekt transferimi brenda 7 ditëve zyrtare pune nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar më sipër.
- 10.10. Vetëm në rast se të gjithë Ortakët janë shprehur se nuk kërkojnë të ushtrojne të drejtën e parablerjes, ose nuk janë përgjigjur sipas kërkesave me sipër, atëherë Ortaku që ka për qëllim të transferojë kuotat e tij do të jetë i lirë t'i transferojë këto kuota personit/ave të përcaktuar në njoftimin e tij pasi të marri miratimin sipas përcaktimeve të nenit 10.2 me sipër.
- 10.11. Çdo transferim i kuotave që nuk kryhet në përputhje me parashikimet e Statutit është i pavlefshëm dhe pa efekte.

KAPITULLI IV **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

Neni 11. **Kuorumi dhe Kompetencat**

- 11.1. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarres i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 11.2. Në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët të cilët përfaqsojnë më shumë se 3/4 të kuotave. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e Përgjithshme do të thirret serish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë. Vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme miratohen me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës në Asamblenë e Përgjithshme.
- 11.3. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë një shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vlefshmerisht vendime, vetëm nëse ortakët që zoterojnë 100% të votave janë të pranishëm. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e Përgjithshme do të thirret serish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë. Vendimet që kërkojnë shumicë të cilësuar miratohen me 3/4 (tri të katërtat) e votave të ortakeve pjesëmarrës në Asamblenë e Përgjithshme.
- 11.4. Merren vlefshmerisht me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, sipas kuorumit të përcaktuar në paragrafin 11.2., vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- i. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - ii. emerimin dhe shkarkimin e administratorit/eve dhe vendimet për shpërblimin e tij/tyre;
 - iii. emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe vendos për shpërblimin e tyre;
 - iv. mbikqyrjen e zbatimit dhe të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - v. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
 - vi. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - vii. perfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
 - viii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
 - ix. çështje tjetër të caktuara nga ligji dhe ky Statut.

- 11.5. Merren vlefshmërisht me votën pro të ortakeve që përfaqsojnë 3/4 (tri të katërtat) e ortakëve pjesëmarrës, sipas kuorumit të përcaktuar në paragrafin 11.3., vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- Ndryshimi i Statutit;
 - rritja dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
 - transformimi i Shoqërisë;
 - miratimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes;
 - çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 12.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga secili prej ortakëve.
- 12.2. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen të paktën një herë në vit, duke respektuar datën dhe periudhën në përputhje me ligjin shqiptar, me qëllimin për të analizuar bilancin vjetor, fitimet dhe humbjet financiare të vitit të kaluar dhe për të vendosur mbi programin dhe buxhetin e vitit aktual.
- 12.3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar thirren (1) me kërkesën e ortakëve (2) me kërkesën e ekspertit kontabël ose (3) me kërkesën e Administratorit.
- 12.4. Njoftimet për çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme duhet t'u dërgohen ortakëve me postë të regjistruar, ose e-mail, në adresat e ortakeve të paktën 10 dite përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përcaktojë datën, vendin dhe rendin e dites së Asamblesë së Përgjithshme. Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të anulohet me ane të kërkesës së njërit prej ortakëve. Megjithatë nëse të gjithë ortaket janë të përfaqësuar në një mbledhje dhe bien dakord me vazhdimin e saj, mbledhja mund të vazhdojë normalisht, pa qenë e nevojshme të plotësohen afatet e njoftimit.
- 12.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet në selinë e Shoqërisë, ose në ndonjë vend tjetër, si të jetë vendosur.
- 12.6. Secili prej ortakëve mund të votojë personalisht ose me prokurë, e cila i lëshohet çdo pale të tretë ose ortakëve të tjerë.
- 12.7. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë në çdo çast vendime të vlefshme, të formes qarkulluese nepermjet (i) postes elektronike, apo (ii) postes së regjistruar, pa qene e nevojshme për ortaket e Shoqërisë të mblidhen fizikisht në një vend të caktuar. Në keto raste Rendi i Dites shpërndahet dhe qarkullohet mes ortakëve nga Administratori i Shoqërisë, nëpërmjet postës elektronike. Ortaket miratojnë vendimin duke i kthyer Administratorit të Shoqërisë një kopje të firmosur të vendimit me shkrim. Ortaket të cilët nuk janë dakord me vendimin shprehin me shkrim kundërshtite e tyre në lidhje me vendimin dhe i'a kthejnë atë Administratorit të Shoqërisë. Vendimi me shkrim konsiderohet i vlefshëm nëse miratohet nga shumica e kërkuar në përputhje me Nenin 11, me sipër.
- 12.8. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme qarkulluese, përse kohë kanë votuar të gjithë ortaket e shoqërisë, që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e saj.

KAPITULLI V ADMINISTRATORËT

Neni 13.

Administratorët dhe kompetencat e tyre

- 13.1. Shoqëria drejtohet nga **2 (dy) Administratorë** të cilët do të kenë kompetencat dhe kufizimet si më poshtë vijon.
- 13.2. **Administratorja e Shoqërisë do të jetë Znj. Desara Liko**, lindur në Tiranë më 12.08.1982, me numër personal identifikimi I25812051J dhe emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Znj. Desara Liko është përgjegjëse për veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë sipas kufizimeve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë dhe ligjit në fuqi. **Administratorja Znj. Desara Liko nuk ka kufizime të kompetencave** dhe përfaqëson Shoqërinë në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.
- 13.3. **Administratori i dytë i Shoqërisë, i cili do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme pas regjistrimit të Shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Biznesit**, krahas funksioneve të tjera të përcaktuara në këtë statut, përfaqëson Shoqërinë në çështjet administrative në lidhje me personelin dhe profesionistët e kontraktuar të Shoqërisë. **Administratori i dytë i Shoqërisë ka kufizim të kompetencave**, nuk ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë i vetëm, nuk ka të drejtë të kryejë veprime në emër dhe për llogari të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë ose të firmosë marrëveshje dhe kontrata me palë të treta.

Neni 14.

Propozimi dhe zgjedhja e Administratorit/ëve

- 14.1 Administratori/ët emërohet/n nga Asambleja e Përgjithshme nëpërmjet një vendimi të zakonshëm. Pas miratimit të emërimit të tij, Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të shkarkojë Administratorin/ët për çdo arsye, nëpërmjet një vendimi të zakonshëm.

Neni 15.

Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/ëve

- 15.1. Administratorja **Znj. Desara Liko** ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatiti dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- e) raportoje përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratori i **dytë i Shoqërisë** ka të drejtë e detyrohet të:

- a) përfaqësojë shoqërinë në Zyrën e Punës;
- b) kujdeset për mbajtjen e saktë e të evidencave të punonjësve, kohës së punës dhe të përfaqësojë Shoqërinë në çështje administrative që lidhen me ta;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të evidencave të profesionistëve të kontraktuar të Shoqërisë, termave të kontraktimit dhe të përfaqësojë Shoqërinë në çështje administrative që lidhen me ta;
- d) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 16.

Kufizime të Administratorit të Shoqërisë

16.1 Administratorja **Znj. Desara Liko nuk ka kufizime të kompetencave** dhe përfaqëson Shoqërinë në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.

16.2. Administratori i dytë i Shoqërisë **ka kufizim të kompetencave**, nuk ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë i vetëm, nuk ka të drejtë të kryejë veprime në emër dhe për llogari të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë ose të firmosë marrëveshje dhe kontrata me palë të treta.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË

Neni 17.

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 17.1 Sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, Ortakët duhet të emërojnë ekspertin kontabël të autorizuar (audituesin ligjor) në numrin dhe për kohëzgjatjen e përcaktuar nga ligji Shqiptar.
- 17.2 Eksperti kontabël të autorizuar (audituesin ligjor) kryejn funksionet e kontrollit financiar në përputhje me ligjin Shqiptar.

KAPITULLI VII

AKTIVITETI I SHOQËRISË

Neni 18.

Viti Financiar

- 18.1. Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar fillon në ditën e parë që është themeluar Shoqëria.

Neni 19.

Mbajtja e Llogarive

- 19.1. Shoqëria mban financat në monedhën shqiptare Lek dhe mban bilancin dhe llogaritë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Shqipëri.

Neni 20
Fitimet

- 20.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve, në përpjestim me vlerën e kuotave që ata kanë respektivisht në kapitalin e Shoqërisë, pasi të jenë zbritur nga kjo shumë (i) vlera e humbjeve të pësuarra gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe (ii) të gjitha shumatat e tjera që Asambleja e Përgjithshme vendos të destinojë për fondet e rezervës.

KAPITULLI VIII
NDRYSHIMI I FORMËS LIGJORE: SHPËRNDARJA

Neni 21.
Ndryshimi i formës ligjore

- 21.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të zbatueshëm.

Neni 22.
Shpërndarja e Shoqërisë

- 22.1. Shoqëria mund të shpërndahet në këto raste:
(a) në përputhje me një vendim të marre nga Asambleja e Përgjithshme; apo
(b) në përputhje me ligjin vendas.

Neni 23.
Likuidimi i Shoqërisë

- 23.1. Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të likuidohet me një ose me shumë likuidatore të cilët do të caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

KAPITULLI VIII
TË NDRYSHME

Neni 24.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 24.1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim midis Shoqërisë dhe një ose më shumë ortakëve, në lidhje me këtë Statut ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e tij, duhet t'i referohet dhe përfundimisht të zgjidhet konform këtij Statuti të Shoqërisë, si dhe Marrëveshjes së Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 25.
Terheqja e Ortakëve

- 25.1. Tërheqja ose përjashtimi i një ortaku si dhe pasojat e këtij veprimi do të rregullohen nga Marrëveshja e Ortakëve dhe nga nenet përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 26.
Ligji i zbatueshëm

- 26.1. Ky Statut rregullohet nga dhe duhet të interpretohet sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe çdo ligji tjetër të zbatueshëm.
- 26.2. Me ndryshimin e ligjeve të zbatueshme, Asambleja e Përgjithshme do të reflektojë ndryshimet e dispozitave urdhëruese në këtë Statut.

Neni 27.
Dispozita e fundit

- 27.1. Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 3 (tre) kopje identike në shqip.

ORTAKËT THEMELUES
TË
SHOQËRISË

PROINFINIT AUDIT TAX & CONSULTING SH.P.K.

Desara Liko



Glen Papadhima

